



Republika e Kosovës – Republic of Kosova
Komuna Hani i Elezit- Municipality of Elez Han



07/ 1629 2022

Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativë nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtori i DSHMS në Hani i Elezit rishpall këtë:

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Pastrues/e e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr.Menduh Kaloshi”Hani i Elezit, një (1) pozitë.

Institucioni: Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr.Menduh Kaloshi”Hani i Elezit

Drejtoria:Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i Pozitave:një (1)

Titulli i mbikëqyrësit:Drejtori i QKMF-së

Grada/Koeficienti:Koeficienti **H-81,H-314/1**

Kohëzgjatja e Kontratës: (pa afat)

Orët e punës:40

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të pastron me thithëse elektrike dhe mjete tjera të përshtatshme dyshemetë në ambientet punuese dhe ato ndihmëse.
2. Të i pastron pluhurat dhe të i lustron orëditë dhe pajisjet e ndryshme
3. Të i mbledh mbeturinat nga dyshemetë dhe vendet tjera ku gjinden, ti fshin,fërkon dhe lustron.
4. Të i pastron të gjitha muret,dritaret dyert dhe vendet tjera dhe nuk duhet ta pengoj procesin e punës.
5. Të i pastron dhe dezinfekton rrobat,kuzhinën ,tualetet,dyshemetë dhe pajisjet në banje.
6. Të bënë pastrimin e vendeve të cilat mund të jenë të kontaminuar duke përcjellur protokollet antiseptike.
7. Të i zbrazë dhe të pastron shportat e mbeturinave duke zbatuar protokollin e hedhjes së mbeturinave.
8. Të i pastron fushat rreth objektit,hyrjet ,daljet dhe mirëmban parkun e objekteve shëndetësore.
9. Përpilon raporte ditore javore dhe mujore për punën e kryer dhe bënë planifikim dhe kërkesën e mjeteve për kryerje të punës si dhe merr pjesë nëpër komisione.
10. Të kryen edhe detyra tjera që kërkojnë nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitetin e lartë në punë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar,kanë mbaruar shkollimin e mesëm dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave të punës.

Dokumentet e nevojshme:

- Dëshminë për shkollimin e mbaruar (e vërtetuar).
- Dokumentin e identifikimit.
- Certifikatën mbi gjendjen shëndetësore
- Certifikatën që nuk është nën Hetime.
- Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse ka).
- Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve komunale (Tatimit në Pronë)
- Kualifikime tjera (Trajnime).

Periudha e kontratës: 6 muaj punë provuese me mundësi vazhdimi në bazë të rezultateve në punë

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data **03.03.2022** deri **17.03.2022 (16:00)**.

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit e marrin pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatet nga lista e ngushtë.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në tabelën e shpalljes.

Drejtores e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Kujtim Ruka-Hasallari

